



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**  
**DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

**Lënda: Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e  
Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - gusht 2023**

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË  
DREJTAT E NJERIUT**

**Tiranë**

Të nderuar anëtarë,

Në zbatim të pikave 2 dhe 3 të nenit 19 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, po ju parashtrojmë dokumentin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - gusht 2023, miratuar me vendimin nr. 07 prot., datë 29.09.2023, të Mbledhjes së Grupit për Menaxhimin Strategjik.

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, është hartuar për shqyrtim dhe miratim nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, relacioni dhe formatet standarde, si pjesë e strukturës së raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar - gusht 2023.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të menaxhimit financiar, monitorimit i kushtohet një vëmendje e veçantë si një nga 5 komponentët shumë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - gusht 2023, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt, sa u përket produkteve të përcaktuara dhe zërave të shpenzimeve, si dhe planifikimit të buxhetit në PBA-në (2023-2025).

Në kërkesat buxhetore për vitin 2023, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, “Çështje të ankimuara/shqyrtuara” me një plan vjetor në masën 90 çështje të regjistruara gjatë vitit 2023. Në këtë parashikim është përfshirë numri i ankimeve që parashikohet të paraqiten gjatë vitit 2023 në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të Juridiskionit të Rivlerësimit (JR), si dhe numri i ankimeve/ kërkesave në kuadër të Juridiksionit Disiplinor (JD). Gjatë periudhës janar - gusht 2023, në KPA janë regjistruar 37 çështje në kuadër të JR-së dhe 3 çështje në kuadër të JD-së, si dhe kërkesa të tjera procedurale për të dyja juridiksionet. Gjatë kësaj periudhe, Kolegji ka dhënë vendime për 36 çështje në kuadër të JR-së, për 1 çështje në

kuadër të JD-së, si dhe janë dhënë vendime lidhur me kërkesa të tjera procedurale të regjistruara në Kolegj.

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, janë përcaktuar në vlerën 207.664 mijë lekë.

Pas ndryshimeve të miratuara me VKM nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, dhe VKM nr. 326, datë 31.05.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të tjera në institucione të administratës publike”, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 12450/1 prot., datë 18.07.2023, është akorduar një shtesë në buxhet për shpenzime personeli në vlerën 7.400 mijë lekë. Plani për periudhën 8-mujore është **159.514 mijë lekë** dhe realizimi **142.331 mijë lekë** ose **89,2 %**.

Shpenzimet buxhetore sipas artikujve kryesorë, paraqiten në tabelën në vijim.

000/lekë					
Llogaria ekonomike	Emërtimi	Plani vjetor (i rishikuar)	Plani 8-mujor	Realizimi 8-mujor	% e realizimit
6000000	Paga	172.740	133.960	125.035	93,3%
6010000	Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	16.420	11.290	11.039	97,8%
6020000	Mallra dhe shërbime të tjera	22.540	10.900	5.081	46,6%
6060000	Trans. për Buxh. Fam. & Individ	1.364	1.364	508	37,2%
2310000	Shpenzime kapitale	2,000	2.000	668	33,4%
	<b>Totali</b>	<b>215.064</b>	<b>159.514</b>	<b>142.331</b>	<b>89,2%</b>

### **I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)**

Buxheti i rishikuar për vitin 2023, në paga është **172,7 milionë lekë** dhe përbën 80% të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në paga, për periudhën janar - gusht 2023, është **134 milionë lekë** dhe realizimi **125 milionë lekë** ose 93,3%.

Kjo vlerë përfshin pagat e punonjësve të strukturës organike prej 57 (pesëdhjetë e shtatë) punonjësish, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 35/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit” dhe pagat për 7 (shtatë) punonjës me kontratë të përkohshme, përcaktuar në VKM-në nr. 56, datë 01.02.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023.

Gjatë kësaj periudhe, llogaritja e pagave dhe e sigurimeve shoqërore për gjyqtarët dhe këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, është kryer sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e pikës 5 të nenit 12 të ligjit 96/2016, për periudhën janar - mars 2023, si dhe të ligjit nr. 33, datë 25.05.2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, gjatë periudhës prill - gusht 2023.

Niveli i realizimit të këtij zëri të shpenzimeve është ndikuar nga fakti që procedurat e rekrutimit për 3 (tre) këshilltarë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, nuk kanë përfunduar gjatë kësaj periudhe.

Theksojmë se pavarësisht mosrealizimit në dukje të buxhetit për periudhën 8-mujore, fondet buxhetore në shpenzime personeli janë të pamjaftueshme për mbulimin e nevojave të Kolegjit deri në fund të vitit 2023. Për këtë arsye, në vijimësi gjatë kësaj periudhe (shkresa e fundit me nr. 711 prot., datë 13.06.2023), është kërkuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë shtesë në buxhet, në vlerën totale **36,6 milionë lekë**, si më poshtë:

- **10,5 milionë lekë në shpenzime personeli, të paplotësuara** me buxhetin e miratuar me ligjin e buxhetit 84/2022 “Për buxhetin për vitin 2023”.

Lidhur me këtë kërkesë, nuk kemi ende një përgjigje nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

- **26,1 milionë lekë në shpenzime personeli, për zbatimin**, që nga momenti i hyrjes në fuqi, të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese (vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 09.01.2023) në llogaritjen e pagës së gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor.

Lidhur me këtë kërkesë, Këshilli i Ministrave, në vendimin nr. 437, datë 19.07.2023, “Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”, ka përcaktuar një shtesë në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në vlerën 15.600.000 lekë, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023 - 31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit.

## **II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)**

Buxheti i rishikuar për vitin 2023 në sigurime shoqërore dhe shëndetësore është **16,4 milionë lekë** dhe përbën 7,6% të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në zërin sigurime shoqërore, për periudhën janar - gusht 2023, është **11,3 milionë lekë** dhe realizimi **11 milionë lekë** ose 97,8%. Fondi për kontributet e detyrueshme të sigurimeve është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, dhe në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga, si rrjedhojë argumentet që lidhen me fondin e pagave, vlejné edhe për këtë zë.

## **III - Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)**

Në këtë zë përfshihen një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale. Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2023, është **23,6 milionë lekë**, dhe përbën 11% të buxhetit total vjetor.

Buxheti i rishikuar, pas transferimit të fondit në vlerë 1.100 mijë lekë nga artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në artikullin 606 “Trans. për Buxh. Fam. & Individ” për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët e Kolegjit, është **22,5 milionë lekë**.

Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për periudhën janar - gusht 2023, është **10,9 milionë lekë** dhe realizimi **5,1 milionë lekë** ose 46,6%.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim.

<b>MALLRA DHE SHËRBIME</b>	<b>Realizimi viti 2023 (në lekë)</b>
Shpenzime për energji elektrike	<b>863.548</b>
Shpenzime për furnizimin me ujë	<b>39.660</b>
Shërbime telefonie fikse	<b>18.552</b>
Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar	<b>131.315</b>
Shpenzime publikimi në shtyp për pozicionet vakante në institucion	<b>343.200</b>
Shpenzime qiraje për ambientet shtesë	<b>952.000</b>

Shpenzime udhëtimi dhe dieta për shërbim jashtë vendit	<b>190.550</b>
Shpenzime për blerje uji të pijshëm për personelin dhe seancat gjyqësore	<b>188.620</b>
Shpenzime për kanceleri dhe letër	<b>350.000</b>
Shpenzime për materiale pastrimi, higjieno-sanitare	<b>237.600</b>
Shërbime telefonie celulare	<b>412.136</b>
Shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës	<b>351.200</b>
Shpenzime për tatime dhe taksa	<b>188.123</b>
Shpenzime për mirëmbajtjen e faqes zyrtare	<b>80.000</b>
Shërbime transporti (parkim, larje, sigurim dhe mirëmbajtje për automjetin e institucionit)	<b>314.442</b>
Karburant për automjetin e institucionit)	<b>225.648</b>
Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik (regjistra dhe lidhje kodeksesh)	<b>101.784</b>
Shpenzime për uniforma për seancat gjyqësore	<b>24.000</b>
Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit video në sallën e gjyqit	<b>32.800</b>
Shpenzime për mirëmbajtjen e fikëseve të zjarrit	<b>18.000</b>
Shpenzime për dezinfektim ambientesh	<b>18.000</b>
<b>TOTALI</b>	<b>5.081.178</b>

Gjatë periudhës janar - gusht 2023, janë shlyer detyrimet lidhur me shpenzimet për energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar), telefoni fikse, si dhe publikime në media të vendeve të shpallura vakante në institucion, për një vlerë totale prej 1.396.275 lekësh.

Janë kryer shpenzime për pagesën e qirasë të ambienteve shtesë për nevojat e institucionit në vlerën 952.000 lekë, si edhe shpenzime për tatime dhe taksa në vlerën 188.123 lekë, që në pjesën më të madhe përbëhen nga pagesa e tatimit në burim për pagesën e qirasë.

Janë kryer shpenzime për telefoninë celulare ku përfshihen prokurimi i shërbimit për Kryetarin e Kolegjit, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe drejtuesit e administratës, sipas kuotës mujore, përcaktuar me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, në vlerën 412.136 lekë.

Janë kryer shpenzime për një udhëtim pune të titullarit të institucionit jashtë shtetit, në vlerën 190.550 lekë.

Janë kryer shpenzime për automjetin e institucionit, duke përfshirë furnizimin me karburant, pastrimin, mirëmbajtjen dhe vend parkimin, me vlerë totale 540.090 lekë.

Në realizimin e kësaj periudhe janë përfshirë shpenzime që u përkasin kontratave në vazhdim nga viti 2022, për sigurimin e jetës dhe shëndetit, për punonjësit e rinj të rekrutuar gjatë kësaj periudhe, për një vlerë totale prej 351.200 lekësh.

Janë plotësuar nevojat e institucionit për materiale dhe shërbime të nevojshme gjatë aktivitetit të përditshëm të institucionit, ku përfshihen shpenzime për kancelari, letër A4, materiale, furnizimi me ujë të pijshëm për personelin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore, në vlerën 776.220 lekë, si dhe mirëmbajtja e faqes zyrtare në internet të institucionit, në vlerën 80.000 lekë.

Janë kryer shpenzime të tjera specifike, ku përfshihen prodhim dokumentacioni dhe kodeksesh, uniforma për seancat gjyqësore etj., me vlerë totale 194.584 lekë.

Në nivelin e realizimit për kategorinë mallra e shërbime, për këtë periudhë, ka ndikuar edhe fakti që janë ende në proces procedurat e prokurimit për sigurimin e jetës, shëndetit, për gjyqtarët e Kolegjit, personave të lidhur të tyre, këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe stafit administrativ (vijon proceduara), shërbimit të mirëmbajtjes për serverët, kompjuterët dhe pajisjet e zyrës (finalizuar në muajin shtator), si dhe furnizimin me tonera

për pajisjet e printimit (vijon procedura), që në vlerë totale përbëjnë rreth 50% të buxhetit të parashikuar për mallra dhe shërbime.

#### **IV - Shpenzimet për Trans. për Buxh. Fam. & Individ (Ilogaria ekonomike 606)**

Buxheti i detajuar në këtë zë është në vlerën 1.364 mijë lekë dhe realizimi 508 mijë lekë ose 37,2%.

Në këtë grup përfshihet fondi i veçantë në vlerë 264 mijë lekë, miratuar me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, si dhe fondi në vlerë 1.110 mijë lekë për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët e Kolegjit, transferuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 4290/1 prot., datë 09.03.2023, nga artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në artikullin 606 “Trans. për Buxh. Fam. & Individ”.

Gjatë kësaj periudhe është kryer rimbursimi i shpenzimeve telefonike të gjyqtarëve sipas përcaktimit në VKM nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, për periudhën janar - maj 2023, në vlerën 418.623 lekë, si dhe pagesën në vlerën 90.000 lekë, si ndihmë financiare për tri raste fatkeqësie në familje, sipas përcaktimeve në VKM nr. 929, datë 17.11.2020, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.

#### **V. Shpenzimet kapitale (231)**

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2023, në investime është **2 milionë lekë** dhe përbën rreth 0,9% të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në zërin investime, për periudhën janar - gusht 2023, është **2 milionë lekë** dhe realizimi **668 mijë lekë** ose 33,4 %.

Këto fonde janë parashikuar për plotësimin e nevojave për punonjësit shtesë të miratuar në strukturën organike me vendimin e Kuvendit nr. 35/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, si dhe të nevojave të tjera të institucionit, për pajisje kompjuterike në vlerën 1,2 milionë lekë dhe pajisje e mobilie zyre në vlerën 800 mijë lekë.

Gjatë periudhës janar - gusht të vitit 2023, janë përmbyllur procedurat e prokurimit për pajisje elektronike (kompjuter, laptop etj.) në vlerën 428 mijë lekë dhe pajisje e mobilie zyre në vlerën 240 mijë lekë.

Në lidhje me sa më sipër, bashkëlidhur gjeni formatet standarde për raportimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar - gusht 2023.